



KUJDES: Aderimi/Anëtarësimi në këtë organizatë kërkon një farë fryme dhe pikpamje Vizionare e cila lidhet pazgjidhshmërisht me dy faktor shumë të rëndësishëm, me Aspiratën/Dëshirën që të gjithë sëbashku ti ofrojmë vendit një mundësi për përparim dhe drejtësi gjithpërfshirëse, pra një të mirë të përbashkët ose me aspektet profesionale të sajë. Nëse nuk ekzistojnë njëra nga këto dy ndjesi, pra aspirata, të gërshetuara këto më sipër me cilësi si idealist/e, guximtar/e, vizionar/e anëtarësimi në këtë organizatë nuk është i rekomandueshëm.

Organizata e Drejtësisë është një Organizatë ndërkombëtare jo-fitimprurëse, jo-fetare dhe jo-politike e regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 6784, datë 22.11.2021, me Nr. Nipti. M12402453J, e regjistruar në organet tatimore me datë 02.12.2021.

Organizatë VLERORE & Shoqëri Zhvilluese, sociale dhe profesionale, multidisiplinare e specializuar në fushën e drejtësisë, në vëmendje të sajë qëndron Individi dhe vlerat humane. Vizioni i organizatës është në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve që ajo është zotuar ti mbrojë dhe përfaqësojë, vizioni i saj është dhe shtet ndërtues mbi parime Barazie, Drejtësie, Proporcionaliteti etj. Shërbimet dhe aktivitetet e organizatës ofrohen falas për anëtarësinë e sajë nga momenti i anëtarësimit.

Në bazë të statutit pjesë e jona mund të jetë kushdo që ka zotësi të plotë juridike për të vepruar sipas legjislacionit të shtetësisë së tij, pa dallim shtetësie, race, kombësie, feje, gjinie etj. Anëtarësimi dhe Ç'anëtarësimi është vullnetar. Pjesëmarrja në trajnime dhe aktivitete është fakultative/opsionale dhe jo me detyrim, mundësia e pjesëmarrjes në trajnime dhe aktivitete mundësohet Fizikisht ose ZOOM sipas dëshirës.

QËLLIMI/MISIONI

Luftojmë kundër padrejtësive në shoqërinë tonë dhe promovojmë parimin e shtetit të së drejtës bazuar në të drejtat e njeriut. Ky organizim ka për qëllim të jetë institucion i specializuar në fushën e drejtësisë. Të kontribuojë për vendosjen e një klime pozitive gjithpërfshirëse dhe stabiliteti ligjor, kudo që do të ushtroj aktivitetin e saj jo-fitimprurës, në shërbim të anëtarësisë së saj dhe mbarë shoqërisë duke përcjellë vlera dhe virtyte të larta humanizmi, drejtësie, bashkëpunimi, integriteti, profesionalizmi, socializimi, disponibiliteti, proporcionaliteti etj.

- Të kontribuojë për vendosjen e një tradite ligjshmërie dhe zbatimit rigoroz të ligjit.
- Të kontribuojë për përmirsimin e legjislacionit, respektimit dhe zbatimit të tij.
- Të kontribuojë për ekuilibrimin e sistemit të drejtësisë dhe konsolidimin e tij.



- Të kontribojë në çdo sferë të marrëdhënieve individ-subjekt juridik privat apo individ subjekt juridik publik dhe ka për qëllim përmirsimin e standarteve jetësore të shoqërisë në tërësi.
- Të kontribojë për inkapsulimin e faktorëve negativ në shoqëri dhe ti shpërbëjë ato, me qëllim përparimin e shoqërisë.
- Të kontribojë për implementimin e kulturës ligjore në shoqëri, edukimin vazhdues të anëtarësisë dhe komunitetit për respektimin e ligjit.

Qëllimi unik është Evoluimi si një institucion i fortë i karakterizuar nga paanësia, pavarësia, integriteti, në shërbim të subjekteve që është zotuar ti përfaqësoj dhe mbrojtë, për të arrirë qëllimin final, balancimin dhe performancën e sistemit në tërësi, duke i shërbyer interesit më të lartë të shoqërisë ku do të zhvillojë aktivitetin e saj jo-fitimprurës.

OBJEKTIVAT DHE PROGRAMI

Në qendër të vëmendjes së organizatës qëndron individi dhe vlerat njerëzore. Objektivat e ndërtimit dhe vizioni i organizatës janë në funksion të mbrojtjes së të drejtave, interesave të ligjshme dhe lirive themelore të subjekteve që ajo është zotuar ti mbrojtë dhe përfaqësojë, vizioni i saj është dhe shtet ndërtues mbi parime barazie, drejtësie, proporcionaliteti etj.

Organizata do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin e çdo shteti ku do të ketë degët e saj. Shoqata është një organizatë përfaqësuese, mbrojtëse, edukative, shkencore, përcjellëse e kulturës ligjore, objektivat e së cilës janë:

- Të përcjellë Vlera, Edukim, Këshillim, Formim, Mbrojtje Përfaqësim, Promovim, Bashkëpunim tek subjektet fizik e juridik privat ose publik.
- Të rekrutojë Anëtarësi, brenda përcaktimeve që lejon ligji dhe Statuti.
- Të organizojë fushata të gjera me qëllim sensibilizimin dhe anëtarësimin e subjekteve.
- Rekrutimi dhe përfshirja e Juristëve, Avokatëve, Magjistratëve, Studenteve të Drejtësisë, në veprimtarinë dhe programin e organizatës me qëllim ndërveprimin, Bashkëpunimin dhe formimin profesional të tyre.
- Të ofrojë mundësi kualifikuese e profesionale për anëtarësinë e saj.
- Promovimi i Anëtarësisë me çdo mjet të ligjshëm.
- Të orientojë anëtarësinë nëpërmjet kualifikimesh e trajnimesh me qëllim formimin profesional dhe social.
- Të organizojë konferenca me Anëtarësinë.
- Të mbështeti anëtarësinë juridikisht sipas ligjeve të vendit ku ndodhen për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre sipas statusit që ata përfitojnë.
- T'ju sigurojë njoftime për azhurnime të vazhdueshme në lidhje me ndryshimet ligjore.



- Të mundësojë ndërmjetësimin për punësimin e anëtarësisë së organizatës në institucione të ndryshme private ose publike.
- Shkëmbimi i eksperiencave me organizata homologe vendase ose të huaja.
- Të organizojë veprimtari çlodhëse për anëtarësinë, si festa, udhëtime, eskursione, evente etj.
- Të organizojë kurse/trajnime periodike dhe kërkim shkencor në fusha të ndryshme të shkencës.
- Shkëmbimi i eksperiencave të ndryshme ligjore midis anëtarësisë si brenda dhe jashtë vendit.
- Të marrë pjesë dhe të aplikojë në projekte të ndryshme të organizuara nga Organizata Botërore ose Rajonale nga pushteti qendror ose ai lokal.
- Të ofrojë mbrojtje ligjore dhe përfaqësim për anëtarësinë e saj kur vlerësohet si e drejtë dhe e nevojshme nga organizata sipas bindjes së saj të brendëshme dhe të arsyeshme.
- Ti dalë në mbrojtje dhe të përfaqësojë të drejtat dhe liritë e anëtarësisë nëse ato çënohen, shkelen, mohohen, nga një institucion publik, privat ose nga një individ tjetër, apo ka gjasa të ndodhë, aq sa asistencë ligjore e dhënë Anëtarësisë të jetë e përballueshme nga organizata dhe të vlerësohet si e drejtë prej saj, bazuar në bindjen e saj të brendëshme dhe të Arsyeshme.
- Të ofrojë konsulencë dhe opinione juridike të ndryshme subjekteve që aspirojnë të anëtaresohen dhe Anëtarësisë ekzistuese, më qëllim Edukimin ligjor të tyre dhe ndërgjegjësimin, duke përcjellë kulturë ligjore dhe vlera edukative.
- Asistencë Ligjore ose Gjyqësore e ofruar për Anëtarësinë jepet nga organizata kur ajo e vlerëson si të drejtë, duhet të jetë proporcionale e përballueshme për organizatën, brenda mundësive që ajo ka në dispozicion si burime njerëzore dhe financiare.
- Të shesë, blejë, marrë si dhurime, çdo trashëgimni, pronë apo dhurim për objektivat e organizatës.
- Te japë grante, bursa studimi apo ndihma financiare individëve, grupeve të personave apo organizatave në përputhje me objektivat e Shoqatës.
- Të botojë gazeta, revista, libra dhe monografi që kanë të bëjnë me aktivitetet e saj, mund të ketë mediën e saj të lirë për arritjen e objektivave dhe qëllimeve të ligjshme.
- Te organizojë të gjitha aktivitetet me qëllim të mbledhjes së fondeve financiare për të realizuar objektivat e saj.
- Çdo shërbim apo aktivitet i dhënë nga organizata për anëtarësinë e sajë është mbi baza vullnetarizimi, organizata nuk detyrohet të japë shërbime apo aktivitete me detyrim, kur ajo nuk e vlerëson të arsyeshme dhe të drejtë.

Çdo konflikt i mundshëm midis Organizatës dhe anëtarësisë preferohet të zgjidhet me mjete paqësore jashtë-Gjyqësore.

Nr cel/WhatsApp: 00355(0)694900444

webpage: <https://justice-org.apptirana.al/>

Adresa: Rruga "Teodor Keko", Pallati "Mesaplik 05", Shkalla 3, Apartamenti 2, Tiranë
(Albania) e-mail justice.org1@gmail.com Nr Tel/WhatsApp 00355 (0) 694900444



e-mail: justice.org1@gmail.com

SHTYLLA E PARË **(Qytetarët | Bizneset | Ojft-të)**

Qytetarët nuk do duhet të kenë më pasigurinë se të drejtat apo liritë e tyre do të shkelen, cënohen, mohohen apo nëpërkëmben nga individë të tjerë apo subjekte private ose publike qofshin, nga momenti që Anëtarësoheni tek Organizata e Drejtësisë, në do t'ju paisim me të gjithë informacionin ligjor të nevojshëm këshillimor që të drejtat tuaja t'i ushtroni plotësisht në përputhje me kushtetutën dhe ligjet, jemi zotuar t'iu mbrojmë me çdo kusht brenda kornizave ligjore që të drejtat tuaja mos të shkelen, nëpërkëmben apo mohohen.

Në rastin e Bizneseve, jemi zotuar për inkurajimin dhe nxitjen e bizneseve të reja dhe atyre të konsoliduara tashmë, që nga momenti i anëtarësimit nuk do duhet të kenë më pasiguri për mënyrën dhe sigurinë e ushtrimit të aktivitetit të tyre fitim-prurës, asistencë fillon që nga këshillimi për hartimin e Akt-themelimit, Statutit, Kontratave të ndryshme, regjistrimit dhe monitorimit, do të jemi mbrojtësit e subjektit në raste të cënueshmerisë të të drejtave të tijë. Për bizneset tashmë të konsoliduar asistencë nga momenti i anëtarësimit dhe monitorim për ligjshmërinë e veprimeve të kryera dhe mbrojtje nga paditë që mund të ngrihen ndaj tijë.

- **Këshillime & Rekomandime për mbrojtje ligjore dhe Gjyqësore në rastet kur Biznesit/Aktivitetit i cënohen, mohohen, shkelen, nëpërkëmben të drejtat dhe interesat e ligjshëm.**
- **Këshillime & Rekomandime për paisje me strategji kontratash nga më përparimtarët, zgjidhje jashtë gjyqësore dhe sigurtë që mbrojnë marrëdhëniet e Aktivitetit/Biznesit në raport me stafin/ekipin e punës por edhe ndaj të tjerëve, si kompani kolaboruese etj, duke bërë të mundur dhe mbrojtur në maksimum të drejtat dhe interesat ligjorë e finacier të kompanisë/biznesit.**
- **Tregëtimi i produkteve, mallrave ose shërbimeve të Biznesit/Aktivitetit kompanive të tjera brenda anëtarësisë së Organizatës.**
- **Promovi i produkteve, shërbimeve dhe mallrave që Aktiviteti/Biznesi ofron për të tretët nga vetë organizata.**
- **Klimë bashkëpunimi për projekte fitimprurëse të ndryshme ku Aktiviteti/Biznesi ka interes.**
- **Këshillime & Rekomandime vazhduese për mënyrën sesi duhet ta zhvillojë Aktivitetin/Veprimtarinë Biznesi për të qenë në legjitimitet të plotë.**



ORGANIZATION OF JUSTICE
GUARDIANS OF HUMAN RIGHTS
VALUE ORGANIZATION



- Keshillime & Rekomandime per përfaqësim ligjor, hartimin e dokumentacionit juridik të të gjitha fushave (civile, administrative, tregtare)
- Keshillim & Rekomandime për përgatitjen e kërkesë padive ose kërkesave për çështje gjyqësore, si dhe e kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore, atyre të organit Arbitrazhit ose të organeve të administratës publike.
- Keshillime & Rekomandime per përgatitjen e ankesave dhe kërkesave të personave fizik ose juridik privat ose publik.
- Keshillim & Rekomandime për përpilim të akteve që i nënshtrohen veprimeve noteriale.
- Këshillim & Rekomandime për hartimin e kontratave e marrëveshjeve, si dhe i çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike.
- Këshillim & Rekomandime për përfaqësimin e personave fizik ose juridik në çështjet civile dhe administrative, në Gjykatë, në Arbitrazh dhe në organe të tjera të administratës publike.
- Keshillim & Rekomandime për veprime të tjera ndihmëse juridike që parashikohen në ligje të veçanta dhe akte të ndryshme ligjore.
- Këshillim & Rekomandime për Regjistrimin e Markave/Dizenjove Tregtare.
- Këshillim & Rekomandime për viza pune, Leje pune dhe Leje qëndrimi.
- Këshillim & Rekomandime për Legjislacionin Bankar.
- Regjistrimi i kompanive: SHPK, regjistrim dege në Shqipëri, regjistrimi zyre përfaqësimi në Shqipëri, Mbledhje borxhi etj, shërbime të tjera sipas nevojës së aktivitetit etj.

Në rastin e OJF-ve qofshin Shoqata, Qendra apo Fondacione, monitorojmë hap pas hapi procedurat e krijimit, organizimit dhe funksionimit deri në detaj, me qëllim që të jenë në përputhje me ligjet e RSH, asistencë këshillimore hap pas hapi për mbarëvajtjen e proceseve të rizgjedhjeve të anëtarëve të organeve drejtuese, ndryshimet statutores, vendime etj, ligjshmëria është e garantuar.

SHTYLLA E DYTË **(Juristët | Avokatët)**

Qëllimi i posaçëm i Organizatës së Drejtësisë si organizim profesional dhe shoqëror është zotuar që të lartësojë figurën e Juristit dhe Avokatit në fushën e biznesit. Nëse jeni Jurist apo Avokat dhe dëshira juaj është të punoni si të pamvarur dhe të ndërtoni aktivitetin tuaj në fushën e shërbimeve ligjore, por nuk dini nga t'ja nisi? Tek shoqata juristët dhe avokatët shqiptarë organizohen praktikat



dhe strategjitë më efektive në biznesin shqiptar të shërbimeve juridike, ku ndër to organizohen senca të drejtëpërdrejta me klientët e zyrave të juristeve apo Avokatëve me të spikatur në këtë treg. Juristi apo Avokati i ri në profesion i jepet kontakti i drejtëpërdrejtë me klientë të ndryshëm të gatshëm të marrin shërbimet ligjore të ofruara nga Shoqata, pra Anëtarit i jepet mundësia të komunikojë me individet dhe të krijojë ai vetë një strategji mbrojtëse nën asistencën e Juristeve apo Avokatëve më në zë. Hartimi i akteve Juridiko-Proceduriale të natyrave të ndryshme si Civile, Administrative, Penale, të cilat janë instrumenti thelbësor për ndjekjen e procedurave nga Juristi apo Avokati pranë institucioneve kompetente private ose publike qofshin. Jeni Jurist apo Avokat i ri në profesion dhe nuk keni Ambient zyrash ku të prisni individë për dhënie konsulencash? Mos u shqetësoni, pasi pranë selisë janë Studiot Ligjore ku mund të jepni sa asistencë të dëshironi dhe të paguheni për këtë fakt, organizata ndër të tjera ofron mundësi punësimi brenda organizatës për anëtarësinë e sajë.

Udhëzimet me të suksesshme sesi të filloni biznesin, si të ndërtoni profilet tuaja profesionale me target grup klientë potenciale të gatshëm të marrin shërbimet tuaja dhe të paguheni për këtë fakt. Mbi të gjitha strategjitë dhe orjentimet në tregun e shërbimeve juridike ofrohen me 0 kosto nga momenti i anëtarësimit, aplikoni dhe bëhuni pjesë menjëherë në këtë organizim profesional dhe shoqëror, që të përfitoni nga programi dhe aktivitetet e shoqatës dhe vizioni i sajë.

Përfitimet:

- **Si të ndërtosh një aktivitet tendin në fushën ligjore ose si ta risësh atë.**
- **Ambiente zyrash falas për takime me klientë potencialë ose trajnime.**
- **Trajnimet vazhduese falas fizikisht ose zoom.**
- **Asistencë për raste komplekse të aktivitetit tuaj.**
- **Mundësi punësimi brenda organizatës.**
- **Delegim punësh/dhënie pune.**
- **Promovim si profesionist/e nga Organizata**
- **Mbrojtje e të drejtave dhe lirive themelore nga vetë organizata.**
- **Aktivitete Kulture, Artistike, Shlodhëse si festa, udhëtime, eskursione, evente etj.**

SHTYLA E TRETË (Studentët e Drejtësisë)

Në universitete praktika apo Gjyqet imituese zhvillohen shumë pak apo aspak? pa merak jeni në vendin e duhur ku zhvillohen Gjyqet simuluse me natyrë Civile, Penale, Administrative. Aktet juridiko-proceduriale vetëm i shihni në formë por vendosja e elementëve procedural ju percjell pasiguri? mos u shqetësoni fare, do jetë gjëja me elementare që do dini të bëni pas anëtarësimit në organizatë. Si të flisni me një klient, si të drejtoheni atij? ofrimi i strategjive me të kualifikuara në



tregun e shërbimeve juridike, implementimi dhe zberthimi i tyre është i garantuar. organizata ofron për Studentët e Drejtësisë trajnime për shkrimin Akademik dhe kërkimin shkencor.

Rreth Konceptit, Filozofisë Shteti në kaos, pa-qëndrueshmëria

Të vetëdijshëm për situatën e vështirë që po kalon vendi ynë, në çdo sferë të marrëdhënieve shoqërore, mjafton të sjellësh në mendje Shëndetësinë, Gjykatat, Rendi, kriminaliteti, Institucionet publike të dobta, Burokracia kudo, ekonomia e dobët, rrogat e qytetarëve, ikja e të rinjve, arsimi i dobët, pa perspektivë.

Çdo gjë duket pa Perspektivë, 30 vjet tranzicion dhe jemi aty ku nisëm ose mos më keq akoma, brezi paraardhës dështoi për faktorë të ndryshëm negativë që nuk arritëm dot t'i ndalnim, të paktën mos të dështojmë dhe ne, rinia duhet t'ia dalë ta kthejë këtë vend në një vend model, të begatë, do duhet ta bëjë dhe do ta bëjë.

Në gjendjen aktuale që ndodhet vendi ynë të gjithë biem dakort që kjo gjendje nuk është gjendja më e mirë e mundshme, duhet të bashkohemi dhe të shohim Perspektivën e interesit të përgjithshëm dhe të përbashkët, që çdo mbështetje të krijohet nga një marrëdhënie besimi e cila do duhet të japë rezultate të vlerësueshme dhe të kenaqshme në funksion të përmirësimit të jetës së shoqërisë kudo ndodhen.

Gjithmonë jemi mësuar të themi ose të mendojmë me veten si nuk dolën disa të rinj ndryshe, ti vënë dorën dhe shpatullat ketij vendi, t'i dalin zot? Po pse mos ta fillojmë gjithsecili nga vetja t'i dalim zot vendit duke kontribuar nga pak çdo ditë dhe duke e ngritur vendin në nivelet e të paktën shteteve fqinje si vendet perëndimore, të gjithë e duam dhe e aspirojmë këtë ndryshim.

Jemi munduar shumë ti ofrojmë shoqërisë një model ndryshe organizimi ku nga gjiri jonë të mundohemi të nxjerrim një elitë njerzish me integritet dhe të afte të marrin vendime të rëndësishme për Anëtarësinë në veçanti dhe shoqërine në përgjithësi.

Të shtyrë nga dëshira e madhe e profesionit që kemi, menduam sesi dijen e nxënë mund ta vinim në funksion të vendit tonë, kjo nismë vjen nga dëshira që vendin tonë ta kthejmë në një vend të begatë ku të jetë ndoshta model për vendet e tjera pse jo fundja, nuk na mungon asgjë.

Zgjerimi me Anëtarësi

Limfa jonë jetike, është furnizimi me anëtarësi. Anëtarësia është si të thuash furnizimi me energji, sa me shumë anëtarësi aq më shumë unitet, sa më shumë anëtarësi aq më presion arrin të ushtrosh tek aparati shtetëror për padrejtësitë që mund të ndodhin secilit prej nesh, aq më shumë zgjerim dhe anëtarësi, aq më shumë relevancë fiton tek organizatat dhe përfaqësitë diplomatike në vendin



tonë, aq më shumë Anëtarësi aq më shumë kredibilitet. Kredibiliteti nuk fitohet kollaj, kërkon punë, përkushtim, seriozitet, humanizëm etj.

Si një Familje e madhe me perspektivë zgjerimin, organizata në brendësinë e saj duhet të funksionojë si një familje në kuptimin e mirfilltë të fjalës për të ndihmuar me procedura ligjore Anëtarësinë e saj duke përcjellë informacion ligjor dhe jo vetëm për të përmirësuar sadopak klimen ligjore kudo që organizata do të shtrijë Aktivitetin e saj.

Ushtrimi i presionit lobimit mbi aparatën shtetërore, etiketimi i institucioneve ose zyrtareve të korruptuar

Pse jemi ndryshe ne si organizatë, çfarë është presioni institucional dhe si mund të përdoret?

Paralelizim me organizatat (sindikatat në USA) arrinin të ushtronin një presion dhe lobim të fuqishëm deri në kongresin amerikan, për draftimin dhe amendimin e ligjeve,

Etiketimi i cili si mekanizëm mund të jetë i përdorshëm nga organizata në ato raste kur institucionet ose individë të caktuar edhe pas paralajmërimeve për të disatën herë që të mos shkelin apo çenonjë të drejtat dhe liritë e anëtarësisë së organizatës prapë vazhdojnë me shkeljet e përsëritura, këto subjekte do të etiketohen si shkelës të ligjit në media, rrjetet sociale dhe kudo tjetër, mekanizmi i etiketimit është një mundësi e organizatës ndryshe nga institucione të drejtësisë sepse ato nuk mund ta bëjnë këtë gjë.

Krijimi i besimit tek mbarë shoqëria

Krijimi i besimit është sfidë në vetvete, shumë para nesh e kanë provuar për ta ngritur këtë vend aty ku i takon të jetë, disa e kanë filluar vullshëm por janë dorëzuar me të ngjitur disa shkallë, të duash të ngresh shtetin nuk është hobi as lojë fëmijësh, është një përgjegjësi e madhe, do duhet të kontribuojmë së bashku dhe sigurisht të ndryshojë disi mënyrën e të menduarit të gjërave sigurisht duke filluar gjithsecili nga vetja dhe duke u kufizuar në dobi të interesit të përgjithshëm për shtetndërtim dhe konsolidim.

Të paktën brezat që do të vijnë të trashëgojnë diçka për të cilën do të mburren përpara botës, shpresojmë të vijë kjo ditë. Pra mendojmë që këtij vendi i duhen disa yje të bëra bashkë që të ndajnë vlera, parime, ideale në funksion të ndërtimit të vendit, pa nivele kriminaliteti kaq të theksuar, Shëndetesi përgjegjese, Gjykata e forta, qeveri përgjegjese, pra ne si organizate do të mundohemi të shtrojmë terrenin për një të ardhme më të mirë në vendin tonë, që të gjithë të jetojmë në harmoni dhe ky realitet i trishtë të ndryshojë njëherë e përgjithmon sigurisht është sfidë por dhe perspektivë.



Si mund të arrihet krijimi i besimit tek shoqëria? Krijimi i besimit tek shoqëria mund të arrihet në disa forma.

1. Së pari duke filluar nga brenda organizatës e cila ka aftësinë të rekrutojë dhe anëtarësojë individë, biznese dhe ofr, duke i siguruar ktyre të fundit dhënien e një shërbimi profesional ligjor përtej pritshmërive të tyre dhe për këtë besoj nuk do ket të meta organizata jonë pasi ka aftësinë dhe njohuritë e përgjithshme dhe të posaçme ligjore që të sigurojë një klimë sigurie, mbështetëse, dhe rehatie për Anetaret që bëhen pjesë e saj,
2. Së dyti Edukimi Ligjor që kemi filluar të percjellim në mbarë shoqërinë brenda dhe jashtë vendit, kjo falë dhe Teknologjisë së Informacionit që na mundëson që informacioni që percjellim të kalojë kufinjtë kombëtarë dhe të prekë ato ndërkombëtar, Edukimi dhe ndërgjegjësimi ligjor ka efekt pozitiv në qytetari pasi ndihmon që qytetaret të kuptojnë dhe të sillen konform udhëzimeve që mundëson organizata, pra duke mbajtur qëndrime progresiste qytetarie për sjellje dhe veprime etike.
3. Së treti, më vonë mund të kemi dhe një kanal televiziv ku qytetaret të na ndjekin dhe të jenë pjesë e jona në vendimmarrje të rëndësishme, pra duke i treguar qytetarëve sesi është mënyra më e duhur konform sjelljeve qytetare dhe konform ligjit për t'u sjellë në mënyrën më të mirë të mundëshme.
4. Nuk përjashtohet fakti që me zgjerimin e madh të organizatës mund të lindin mosmarrëveshje midis dy apo më shumë anëtarëve, kto mosmarrëveshje do dijmë t'i sheshojmë me mjete paqësore pra duke siguruar një klimë sigurie dhe Paqeje brenda organizatës por edhe jashtë saj, mjetet paqësore i referohemi mjeteve alternative për zgjidhen e mosmarrëveshjeve, si Pajtimi, Ndërmjetësimi, Arbitrazhi etj. Pra sic vihet re forma, instrumenta ka, duhet vullneti i përbashket për t'ja arrirë qëllimit.



ORGANIZATION OF JUSTICE
GUARDIANS OF HUMAN RIGHTS
VALUE ORGANIZATION



DCREDINS bank

ACCOUNT DETAILS



Kodi SWIFT / SWIFT Code: CDISALTRXXX

Titullarli Logarisë / Account Holder: ORGANIZATA E DREJTËSISË

Nr. Personal | NIPT/SSN | Tax ID: M12402453J

**Adresa / Address: RR. Teodor Keko, PALLATI MESAPLIK 05,
Shkalla nr 3, Apartamenti nr 2, UNAZA E RE, TIRANË, Shqipëri**

Monedha / Currency: ALL

Numri i LLogarisë / Account Number: 0001769883

IBAN*: AL67 2121 1009 0000 0000 0176 9883



Adresa e Selisë: Rruga “Teodor Keko”, pallati Mesaplik 05, shkalla 03, apartamenti 03, Unazë e Re, Tiranë, Albania

Link: <https://maps.app.goo.gl/49KXSQCYykthQLxi6>



Linku Instagramit:

<https://instagram.com/organizata.e.drejtesise?igshid=YmMyMTA2M2Y=>

Linku Facebook:

<https://www.facebook.com/profile.php?id=100074765682691&mibextid=ZbWKwL>



Linku You Tube:

<https://youtube.com/@organizataedrejttese8467>

Linku LinkedIn:

<https://www.linkedin.com/in/organizata-edrejt%C3%ABsis%C3%AB-898471225>

Linku Tik Tok:

<https://www.tiktok.com/@juristet.dhe.avokatet?t=8bwlc4nDowA&r=1>

Linku WebPage: <https://justice-org.apptirana.al/>